


VLERËSIMI I NIVELIT TË ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË PËR TRANSPARENCË TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (2023-2026)

NË PERIUDHËN JANAR 2024 – JANAR 2025




SHKUP, 2025

 **METAMORPHOSIS**

Fondacion për internet dhe shoqëri

HYRJE



Hyrje

Në dhjetor të vitit 2023, Qeveria e miratoi Strategjinë për Transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me Plan Veprimi 2023 - 2026, të propozuar nga Kabineti i Zëvendëskryeministrit Përgjegjës për Politika të Qeverisjes së Mirë. Strategjia u përgatit përmes një procesi të gjerë dhe gjithëpërfshirës, në të cilin u përfshinë përfaqësues nga institucionet shtetërore, komuniteti akademik, shoqëria civile, duke përfshirë edhe Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë, si dhe ekspertë të fushës, me mbështetjen dhe në bashkëpunim me Fondacionin Metamorfozis.

[Strategjia e parë për Transparencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut me Plan Veprimi \(2019-2021\)](#) u miratua në nëntor të vitit 2019, pas një periudhe gjashtëmujore konsultimesh dhe hulumtimesh lidhur me qëllimin dhe përmbajtjen e saj. [Fondacioni Metamorfozis](#) mori pjesë aktive dhe, në bashkëpunim me ministrin e atëhershëm pa portofol përgjegjës për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë, e udhëhoqi procesin e përgatitjes së Strategjisë së parë për Transparencë dhe më pas e monitoroi në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme [zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Transparencë](#), për të konstatuar zbatimin e përpjekjeve për avancimin e transparencës, gjegjësisht të transparencës aktive të institucioneve. Monitorimi tregoi se është e nevojshme të vazhdohet me përmirësimin e transparencës dhe të llogaridhënies së institucioneve shtetërore, gjë që u konstatua edhe nga rezultatet e fituara nga [Indeksi i Hapjes së Fondacionit Metamorfozis](#)¹. Kështu, Fondacioni Metamorfozis dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Zëvendëskryeministrja Përgjegjëse për Politika të Qeverisjes së Mirë, në shkurt të vitit 2023 vendosën bashkëpunim për të përgatitur një Strategji të re për Transparencë të Qeverisë (2023-2026).

Për krijimin e Strategjisë së re u formua një grup pune² në punën e të cilit morën pjesë edhe ekspertë të cilët përgatitën një analizë të situatës aktuale duke i marrë parasysh matjet e fundit nga Indeksi i Hapjes, raportet e shoqërisë civile me të cilat matet transparenca e institucioneve, si dhe raportet monitoruese për zbatimin e planeve të veprimit të Strategjisë për Transparencë (2019-2021). Grupi i punës, me mbështetjen e ekspertëve, kreu një analizë të politikave, ligjeve dhe akteve nënligjore që i rregullojnë parimet e transparencës dhe përgatiti një pyetësor të standardizuar për kryerjen e të paktën 20 intervistave me përfaqësues të palëve të interesuara (*poseduesit dhe kërkuesit e informacionit*). Përveç kësaj, u bë edhe një pasqyrë e politikave për transparencë dhe hapje në politikat e tjera sektoriale dhe strategjitë aktuale. Pasqyra e situatës aktuale rezultoi me përcaktimin e fushave prioritare të Strategjisë për Transparencë.

Fushat prioritare, sipas Strategjisë janë: *avancimi i transparencës aktive, avancimi i qasjes në informata me karakter publik, avancimi i transparencës fiskale të Qeverisë dhe të organeve të tjera të pushtetit*

¹ Indeksi Rajonal i Hapjes realizohet vazhdimisht me rrjetin ACTION SEE. Në kuadër të Rrjetit për Përgjegjësi, Teknologji dhe Hapje të Institucioneve në Evropën Juglindore - ACTION SEE, pjesë e të cilit është edhe Fondacioni Metamorfozis, për tetë vjet rresht është monitoruar hapja e institucioneve shtetërore në Ballkanin Perëndimor përmes Indeksit të Hapjes në bazë të të cilit jepen rekomandime kyçe për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien e tyre me çdo cikël të hulumtimit. Ky Indeks ofron informacion bazë për shkallën në të cilën parimet e qeverisjes së mirë respektohen nga ana e pushtetit ekzekutiv dhe i vendos bazat për përcaktimin e kapitujve të Strategjisë.

² Aktvendim me numrin e arkivit 10-3419/1 të datës 30.3.2023.

ekzekutiv, avancimi i aftësive digjitale të institucioneve për të lehtësuar dhe automatizuar procesin e hapjes së të dhënave, si dhe forcimi i mekanizmave të llogaridhënies për hartimin e politikave.

Strategjia për Transparencë e QRMV-së (2023-2026), së bashku me Planin e Veprimit, rrjedh nga vizioni në vijim: “Republika e Maqedonisë së Veriut njihet për vetëdijen e saj të lartë, si dhe praktikën dhe kulturën e transparencës, në të cilën standardet e qeverisjes së mirë mbizotërojnë në institucionet e pushtetit ekzekutiv, për të siguruar besim të plotë para qytetarëve dhe institucioneve”.

Masat janë shtjelluar më hollësisht në [Planin e Veprimit për periudhën 2023– 2026](#), ku janë konkretizuar me aktivitete, afat kohor të zbatimit, vlerësim të burimeve për mjetet e nevojshme financiare për realizimin e aktiviteteve, cili institucion është bartës i aktivitetit, si dhe institucionet e përfshira në zbatimin e aktivitetit.

Duke qenë se Fondacioni Metamorfozis vazhdon të vlerësojë hapjen e institucioneve përmes Indeksit të Hapjes dhe të japë rekomandime se si të përmirësohet qeverisja e mirë, është zotuar të monitorojë edhe zbatimin e Strategjisë me planin adekuat të veprimit për të matur shkallën e përmbushjes së aktiviteteve të parashikuara, gjegjësisht punën e institucioneve me qëllim të ndërtimit të vetëdijes së lartë, praktikës dhe kulturës së transparencës në institucione.

Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Transparencë përfshin një periudhë dyvjeçare (dhjetor 2023 - dhjetor 2026), dhe përbëhet nga gjashtë kapituj që përmbajnë nga disa përcaktime strategjike, të ndara më tej në masa dhe aktivitete. Për çdo aktivitet ka një kornizë të caktuar kohore dhe organ përgjegjës për zbatim, si dhe tregues të suksesit. Metamorfozis e monitoron zbatimin e aktiviteteve sipas treguesve të suksesit të dhëna në vetë planin e veprimit, kështu që kjo mund të shërbejë si një raport hije për zbatimin e tij.

Meqenëse Qeveria nuk ka publikuar asnjë raport zbatimi në periudhën e kaluar apo “të dhëna për indikacionet, udhëzimet dhe masat...” lidhur me zbatimin e Strategjisë, siç është planifikuar sipas vetë planit të veprimit, ky raport është i vetmi informacion në dispozicion për statusin e zbatimit të kësaj strategjie.

Ky monitorim e vlerëson zbatimin e planit të veprimit në dy dimensione: (1) nëse është zbatuar në kohën e duhur dhe (2) nëse është zbatuar plotësisht, në një mostër të rastësishme prej 40 institucioneve: 20 ministri dhe 20 organe dhe trupa të pushtetit ekzekutiv. Janë përgatitur katër pyetësorë të ndryshëm sipas llojit të institucionit dhe aktiviteteve që ato institucione duhej t’i zbatonin në vitin e parë (janar 2024 - janar 2025): (1) Sekretariati i Përgjithshëm si institucion qendror monitorues dhe organ zbatues, (2) Ministrinë dhe organet e pushtetit ekzekutiv, (3) Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Digjitalizimit, të cilat përveç detyrimeve të përgjithshme që vlejné për të gjitha institucionet, janë përgjegjëse edhe për zbatimin e aktiviteteve të specializuara, dhe (4) Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik për shkak të përgjegjësisë për zbatimin e aktiviteteve të specializuara.

Pyetësorët u dorëzuan në formën e Kërkesave për qasje të lirë në informatat me karakter publik, për të cilat, afati ligjor për përgjigje është 20 ditë. Pyetësorëve iu përgjigjën 33 nga 40 institucione të kontaktuar, gjegjësisht 82,5% e tyre. Prej tyre, numri i institucioneve që janë përgjigjur jashtë afatit të përcaktuar ligjor është 9 institucione, gjegjësisht 5 ministri dhe 4 organe në përbërje të tyre.

Institucionet që iu përgjigjën pyetësorëve tanë për të monitoruar zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë për Transparencë janë këto:

Zyra e Zëvendëskryeministrit Përgjegjës për Politikën e Qeverisjes së Mirë	Byroja për Furnizime Publike
Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së RMV-së	Inspektorati Shtetëror Administrativ
Ministria e Punëve të Brendshme	Byroja e Metrologjisë
Ministria e Ekonomisë dhe Punës	Drejtoria Doganore
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	Drejtoria e Inteligjencës Financiare
Ministria e Mbrojtjes	Drejtoria për Çështje Hidrometeorologjike
Ministria e Drejtësisë	Agjencia e Rezervës së Mallrave
Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	Sekretariati i Legjislacionit
Ministria e Shëndetësisë	Inspektorati Shtetëror për Inspektimin Teknik
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave	Inspektorati Shtetëror i Transportit
Ministria e Administratës Publike	Enti Shtetëror i Statistikave
Ministria e Transformimit Digjital	Inspektorati Shtetëror i Tregut
Ministria e Sportit	
Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale	
Ministria e Financave	
Ministria e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive	

Kërkesa për qasje të lirë në informatat me karakter publik është dërguar më 13 dhjetor 2024 dhe më pas, institucionet që nuk janë përgjegjës janë përkujtuar më 21 janar 2025. Deri në përfundimin e pasqyrës, nuk kemi marrë përgjigje nga 7 institucione, prej të cilave 4 ministri dhe 3 organe në përbërje të tyre.

Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale³ është përgjegjës më 17 shkurt të vitit 2025, plot 66 ditë pas dërgimit të kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik, ndërkohë që ishim duke e finalizuar tekstin e pasqyrës.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme dërgoi një e-mail më 24 janar 2025, duke kërkuar 30 ditë shtesë për të përgatitur përgjigje ndaj kërkesës.

Më 10 shkurt 2025, kemi marrë një e-mail nga Ministria e Kulturës dhe Turizmit ku thuhej: “Në pajtim me nenin 8 paragrafi (3) të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik si dhe Procedurën për Veprim pas Pranimit të Kërkesës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, si person zyrtar për ndërmjetësim, ju njoftoj se afati për dorëzimin e Aktvendimit për miratimin e informatave do të vazhdohet me qëllim që t'i përgjigjemi në mënyrë adekuate kërkesës së parashtruar si posedues të informatave”.

Ministritë dhe organet në përbërje që **nuk u përgjigjën** në Kërkesën për informata me karakter publik janë:

Ministria e Transportit	Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor
Ministria për Çështje Evropiane	Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale
Ministria e Kulturës dhe Turizmit	Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme	

³ Numri i arkivit 08-17/12

PASQYRË



Pasqyrë

Transparenca si parim ka një rëndësi të veçantë për arritjen e qeverisjes së hapur, që do të thotë se publiku ka në dispozicion informacion gjithëpërfshirës, relevant dhe në kohë për aktivitetet e pushtetit ekzekutiv. Hapja do të thotë se qeveria i dëgjon qytetarët dhe botën e biznesit dhe i merr parasysh mendimet e tyre gjatë formulimit dhe zbatimit të politikave publike, ndërsa llogaridhënia, nga ana tjetër, tregon se është i mundur identifikimi i bartësve të funksioneve publike dhe nëpunësve publikë, të cilët duhet të thirren në përgjegjësi për aktet që i kanë miratuar dhe për veprimet që i kanë bërë.

Qeveritë mund të punojnë më mirë kur janë transparente për aktivitetet, procedurat dhe të dhënat e tyre, kur e inkurajojnë pjesëmarrjen e publikut dhe kur i plotësojnë kërkesat e qytetarëve. Prandaj, qeveria është transparente kur publikon në mënyrë proaktive informacione dhe të dhëna që i ndihmojnë qytetarët t'i ushtrojnë të drejtat e tyre, të marrin vendime për jetën e tyre, të ndërmarrin sipërmarrje biznesi, por edhe të kuptojnë se si autoritetet publike marrin vendime dhe si i shpenzojnë fondet publike.

Kjo Strategji për Transparencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut është një dokument trevjeçar që mbulon periudhën dhjetor 2023 – dhjetor 2026, dhe është harmonizuar me nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve, subjekteve afariste dhe institucioneve për të arritur një sistem proaktiv dhe të hapur, e në drejtim të transparencës së plotë dhe ndryshimit të kulturës institucionale drejt demokratizimit më të madh të shoqërisë.

Strategjia, përveç Qeverisë, i drejton edhe: *të gjitha ministritë dhe organet në përbërje të tyre, organet e pavarura të administratës shtetërore, organet e pavarura shtetërore dhe organizatat administrative që i përgjigjen Qeverisë; ndërmarrjet publike të themeluara nga Qeveria-ja dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore* - të ndërtojnë vetëdije të lartë, praktikë dhe kulturë të transparencës së institucioneve, gjegjësisht ta kuptojnë dhe ta pranojnë transparencën si mënyrë e punës.

Drejtimet kryesore të veprimit drejt realizimit të transparencës janë:

- Ueb-faqe uniforme dhe të dhëna të përditësuara nga fushëveprimi i qeverisë dhe institucioneve, të publikuara në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët zyrtare të RMV-së;
- Të gjitha dispozitat dhe aktet ligjore, por edhe dokumentet e tjera që prekin drejtpërdrejt ose tërthorazi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, duhet të jenë të disponueshme, të sistemuara dhe të përditësuara;
- Ndihmë për qytetarët në gjetjen e të dhënave të caktuara (qasja në informata nuk duhet të barazohet me qasjen në dokumente, por me marrjen e të dhënave të vlefshme në format të hapur;
- Qasja në informata nuk duhet të nënkuptojë shpenzime;
- Qytetarët duhet të kenë qasje në shpenzimin e mjeteve buxhetore dhe të hyrave buxhetore, përkatësisht të mjeteve publike - buxheti duhet të prezantohet në formë të kuptueshme dhe të gjurmueshme për qytetarët;
- Qytetarët duhet të kenë qasje në proceset publike dhe në punën e institucioneve, në përdorimin e kompetencave të dhëna dhe kompetencave diskrecionale.

Krahas përmirësimit të transparencës dhe integritetit të institucioneve publike, Strategjia duhet të kontribuojë në mënyrë indirekte edhe në fushat e mëposhtme:

- Transparencë dhe gjithëpërfshirje në hartimin e ligjeve dhe politikave publike;
- Transparencë në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin në menaxhimin e financave publike, ndihmës shtetërore dhe granteve;
- Qasje transparente në të gjitha profesionet publike;
- Transparencë e buxhetit dhe e shpenzimeve publike;
- Rritje e transparencës në hapësirën mediatike dhe në lidhje me financimin e partive politike;
- Përmirësim i koordinimit ndërmjet aktorëve kryesorë dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për të zbatuar parimet e transparencës.

Transparenca aktive e qeverisë dhe e organeve të tjera në pushtetin ekzekutiv

Sipas planit të veprimit, në periudhën midis janarit 2024 dhe janarit 2025, duhej të zbatoheshin aktivitetet nga dy masa në kuadër të kapitullit Transparenca Aktive e Qeverisë dhe e organeve të tjera në pushtetin ekzekutiv. Masa e parë është “Inkurajimi i transparencës aktive përmes qasjes në informata”, ndërsa masa e dytë parashikon “Standardizimin e qasjes ndaj transparencës aktive”.

Përmbledhje e aktiviteteve të planifikuara:

1. Janë mbajtur 3 sesione tematike tremujore të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut-së për të vënë në dukje mospërputhjet në transparencën e poseduesve të informacionit;
2. Broshura, përgatitja e fushatës mediatike dhe materiale të tjera promovuese nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bashkëpunim me Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, shoqatat e qytetarëve, fondacionet dhe mediat;
3. Informacioni i publikuar që rezulton nga përgjigjet e dhëna në kërkesat për qasje në informacion;
4. Krijimi i ueb-seksioneve në ueb-faqen e Qeverisë për Ministrat pa portofol;
5. Është bërë dallimi midis produkteve gazetareske dhe komunikimit të qeverisë duke i shënuar komunikatat për shtyp, videot dhe fotot e krijuara nga shërbimet për marrëdhënie me publikun me filigranë.

Monitorimi i kryer nga Fondacioni Metamorfozis tregon se aktivitetet e planifikuara **zbatohen vetëm me iniciativën e institucioneve, e jo si një veprim i organizuar.**

Për sa i përket angazhimit për vendosjen e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Qeverisë dhe Agjencisë për Qasje të Lirë, Sekretariati i Përgjithshëm, në koordinim me Kabinetin e Zëvendëskryeministrit Përgjegjës për Qeverisje të Mirë⁴, njofton se:

- ❖ Nuk janë mbajtur sesione tematike tremujore të QRMV-së për të vënë në dukje mospërputhjet në transparencën e poseduesve të informatave. Por, edhe sipas Programit për punë, transparenca e Qeverisë aktuale është prioritet kryesor në funksionimin e saj. Roli parandalues i transparencës

⁴ Numri i arkivit 08-17/3

në punën e institucioneve është një nga mekanizmat për përmirësimin e punës së tyre, si në drejtim të rritjes së efikasitetit të tyre, ashtu edhe në zvogëlimin e mundësive për çdo formë keqpërdorimi dhe korrupsioni, për të cilin gjë Qeveria do të angazhohet në mënyrë konsekuente gjatë gjithë punës së saj. Megjithatë, për shkak të ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore⁵, me të cilin u krijuan ministritë e reja, të cilat në përputhje me kompetencat e tyre duhet të ndërmarrin një pjesë të aktiviteteve në përputhje me Planin e Veprimit të ST-së, aktualisht ai është në fazën e ndryshimeve dhe plotësimeve, pas së cilës do të hyjë në procedurën e miratimit nga qeveria.

- ❖ Nuk janë përgatitur broshurat, fushata mediatike dhe materialet e tjera promovuese nga ana e QRMV-së, aktivitetet të cilat duhet të realizohen në bashkëpunim me AMDQLIKP-në, shoqatat e qytetarëve, fondacionet dhe mediat, për të rritur transparencën e institucioneve.
- ❖ Në realizim e sipër është krijimi i ueb-seksioneve në ueb-faqen e Qeverisë për Ministrat pa portofol.
- ❖ QRMV-ja nuk përdor filigranë në asnjë formë, as nuk e shënon ndonjë dokument.

Ministria e Punëve të Brendshme⁶ njoftoi se vetëm videot në YouTube kanë filigranë, ndërsa Ministria e Ekonomisë dhe Punës⁷ u përgjigj se plotësisht i ndjek udhëzimet në librin e standardeve grafik të miratuar nga Qeveria e RMV-së, dhe dërgoi linke deri te publikimet që e konfirmojnë këtë. Është duke u përgatitur filigrani i Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor⁸ në të cilin u bë ndryshimi i emrit të shtetit në Republika e Maqedonisë së Veriut. Ata njoftuan se momentalisht materialet informative nuk shënohen me filigranë. Komunikatat vendosen në memorandum, kurse videot kanë të integruar logon e Ministrisë.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës⁹ sqaron se njoftimet komunikatat dërgohen në memorandum zyrtar të institucionit, të përgatitur në përputhje me librin e standardeve grafik të Qeverisë. Fotografitë dhe videot që u shpërndahen mediave publikohen në ueb-faqen e tyre, si dhe në profilet e institucionit në rrjetet sociale.

Në Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale¹⁰ thonë se komunikatat zyrtare përgatiten në një memorandum me filigran. Deri më tani nuk ka pasur një praktikë të tillë të shënimit të videove dhe fotografive zyrtare në këtë mënyrë. Ministria e Shëndetësisë¹¹ njoftimet dhe komunikatat për mediat i dërgon në memorandum zyrtar, ndërsa fotografitë dhe videot që publikohen nga ngjarjet përgatiten nga një person i punësuar nga kabineti për këtë qëllim.

Ministria e Administratës Publike¹², si dhe Ministria e Politikës Sociale¹³ nuk përdorin filigranë. Sipas përgjigjes së Ministrisë së Mbrojtjes¹⁴, ata përdorin filigran. Ministria e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive¹⁵ njofton se përdorin një memorandum zyrtar dhe e përkthejnë tekstin në gjuhën të cilën e

⁵ <https://ldbis.pravda.gov.mk/PregledNaZakon.aspx?id=67027>

⁶ Numri i arkivit 08-83/52

⁷ Numri i arkivit 08-83/58

⁸ Numri i arkivit 08-83/49

⁹ Numri i arkivit 08-83/57

¹⁰ Numri i arkivit 08-83/59

¹¹ Numri i arkivit 08-83/53

¹² Numri i arkivit 08-17/11

¹³ Numri i arkivit 08-17/7

¹⁴ Numri i arkivit 08-17/2

¹⁵ Numri i arkivit 08-17/9

flasin të paktën 20% e bashkësisë. Nga pikëpamja teknike, thonë ata, përdorimi i filigranit do të fillojë më 1 shkurt 2025. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave¹⁶ nuk i shënon komunikatat e saj me filigran, por ka iniciuar konsultim ndërinstitucional për këtë temë.

Drejtoria Doganore¹⁷ në nivel javor publikon komunikata për konfiskimet e bëra në javën e kaluar, me ç'rast në secilën fotografi të konfiskimit vendoset logoja e Drejtorisë Doganore, gjegjësisht në çdo fotografi dhe video të konfiskimit është vendosur filigran.

Ministria e Sportit¹⁸ është institucion i sapoformuar, thuhet në shkresën e tyre, dhe se në përputhje me nenin 23 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore, dhe në drejtim, njoftojnë se janë duke i harmonizuar standardet me Qeverinë e RMV-së, për zhvillimin e ueb-faqes, e cila, në përputhje me standardet e vendosura, do t'i përmbajë të gjitha pyetjet që i përmban kërkesa jonë.

Qasja në informatat me karakter publik

Në kapitullin "Qasja në informatat me karakter publik" janë tre masa: "Luftimi i praktikave të dëmshme të injorimit (*heshtja e administratës*) të kërkesave për qasje në informata me karakter publik"; "Zbatimi i parimit të delegimit të kompetencës në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik"; "Veprimi në lidhje me kërkesat për qasje të lirë në informatat me karakter publik". Për secilën nga tre masat e planifikuara ka një aktivitet të planifikuar në periudhën që i nënshtrohet monitorimit.

Kjo listë ofron një përmbledhje të masave dhe aktiviteteve të planifikuara në kuadër të këtij kapitulli:

1. Ndryshime të miratuara ligjore për zgjerimin e kompetencave të Agjencisë dhe fshirjen e afatit për paraqitjen e ankesës në rast të heshtjes së administratës.;
2. Akt i miratuar i brendshëm në nivel të institucionit për zbatimin e parimit të delegimit të kompetencave në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik;
3. Procedura të miratuara të brendshme për veprimin e kërkesës për qasje në informacion dhe procedurë për publikimin aktiv të të dhënave me ndihmën e AQLI-së.

Nga përgjigjet e marra nga institucionet mund të konstatohet se ***angazhimi për të deleguar kompetencën në procedurat për qasje në informacion rrallëherë zbatohet, madje edhe me iniciativën e vetë institucioneve.***

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave ka një vendim për një nëpunës zyrtar, por vendimin e kemi marrë me nënshkrimin e udhëheqësit. Ministria e Administratës Publike na dërgoi një shkresë të panënshkruar dhe informacion se nuk ka person të deleguar. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale njoftoi se "*nuk është miratuar akt i brendshëm për delegimin e kompetencës nga ana e personit përgjegjës. Delegimi i kompetencës nuk është i rregulluar në Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik dhe nuk përbën obligim ligjor*".

¹⁶ Numri i arkivit 08-83/55

¹⁷ Numri i arkivit 08-17/8

¹⁸ Numri i arkivit 08-83/48

Ministria e Drejtësisë¹⁹ konfirmoi se nuk është miratuar akt i brendshëm për kompetencën në bazë të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik. Sipas sistematizimit, Ministria e Drejtësisë ka të punësuar një bashkëpunëtor të lartë për ushtrimin e të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik, i cili është edhe person zyrtar. Ministria e Transformimit Digjital²⁰, Ministria e Politikës Sociale dhe Demografisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja e Metrologjisë²¹, Ministria e Mbrojtjes dhe DÇHM-ja²² kanë miratuar akt për delegimin e personit përgjegjës për ushtrimin e të drejtës për qasje të lirë në informata.

Përveç Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik²³, si shembull pozitiv veçojmë Inspektoratin Shtetëror të Tregut²⁴ dhe Inspektoratin Shtetëror Administrativ²⁵, të cilët përveç asaj se u përgjigjën në kohë dhe siç duhet, dërguan edhe përgjigje me vullën e institucionit dhe të nënshkruara nga personi përgjegjës për ushtrimin e të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik, e jo funksionari, gjegjësisht personi i zgjedhur i institucionit.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë²⁶ njofton se në pajtim me nenin 8, paragrafi 1 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, janë caktuar persona zyrtarë për të ushtruar të drejtën e qasjes së lirë në informata me karakter publik, por nuk është miratuar akt i brendshëm për delegimin e kompetencës, gjegjësisht vendimet që merren nënshkruhen nga funksionari i institucionit - Drejtori.

Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në nivel të institucionit për zbatimin e parimit të delegimit të kompetencës, në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, thekson se me akt të personit përgjegjës ka caktuar persona të cilët i trajtojnë kërkesat për qasje të lirë në informatat me karakter publik, për të cilat mbajnë evidencë të veçantë, e cila më pas integrohen në Raportin Vjetor.

Nuk janë miratuar procedura të brendshme për veprimin e kërkesës për qasje në informacion dhe procedurë për publikimin aktiv të të dhënave me ndihmën e AQLI-së, informojnë nga Ministria e Shëndetësisë. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka miratuar procedurë të brendshme për trajtimin e kërkesave dhe të gjitha lëndët e pranuar publikohen në ueb-faqen e institucionit. Ministria e Arsimit dhe Kulturës thotë se e respekton Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik dhe secilës kërkesë i përgjigjet brenda 20 ditëve.

Ministria e Ekonomisë dhe Punës i ka publikuar të gjitha përgjigjet për kërkesat e pranuar për qasje të lirë në informatat me karakter publik. Në Ministrinë e Administratës Publike nuk janë miratuar procedura të brendshme për trajtimin e kërkesave për qasje në informata dhe procedurë për publikimin aktiv të të dhënave. Ministria e Mbrojtjes ka procedurë të brendshme për trajtimin e kërkesave, përkatësisht Rregullore për Transparencë të miratuar në vitin 2018 dhe të përditësuar në vitin 2021. Drejtoria e Policisë Financiare²⁷ ka miratuar Procedurën për trajtimin e kërkesave për qasje të lirë në informatat me karakter

¹⁹ Numri i arkivit 08-83/60

²⁰ Numri i arkivit 08-83/61

²¹ Numri i arkivit 08-83/56

²² Numri i arkivit 08-83/54

²³ Numri i arkivit 08-83/50

²⁴ Numri i arkivit 08-17/5

²⁵ Numri i arkivit 08-83/46

²⁶ Numri i arkivit 08-83/44

²⁷ Numri i arkivit 08-17/4

publik. Në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë është zhvilluar një procedurë për punën e Sektorit për Koordinim dhe Asistencë Teknike, e cila e rregullon trajtimin e kërkesave në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informata. E njëjta procedurë i specifikon kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të Njesisë për Marrëdhënie me Publikun për sa i përket informimit në kohë të publikut.

Në Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale janë miratuar procedura të brendshme për trajtimin e kërkesave për qasje në informata dhe procedurë për publikimin aktiv të të dhënave. Ministria e Drejtësisë nuk ka miratuar procedura të brendshme.

Në përgjigjen e Ministrisë së Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive thuhet *“udhëheqësia e re e Ministrisë së Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive ka konstatuar se ish-Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive nuk aspak nuk kishte miratuar procedura për punën e ministrisë. Për këtë qëllim është formuar grupi i punës për miratimin e procedurave me Aktvendimin nr. 04-742/1, të datës 2.12.2024, e cila punon në përgatitjen e disa procedurave të brendshme, duke përfshirë procedurën e brendshme për furnizime publike dhe procedurën e brendshme për trajtimin e kërkesave për qasje në informata dhe procedurën për publikimin aktiv të të dhënave me ndihmën e AQLI-së. Në përputhje me Strategjinë për Transparencë të Qeverisë së RMV-së, procedurat do të publikohen në ueb-faqen e ministrisë gjatë muajit të ardhshëm”*.

Byroja e Metrologjisë nuk i ka publikuar politikat e brendshme dhe proceset për trajtimin e kërkesave për qasje të lirë në informatat me karakter publik. Drejtoria e Inteligjencës Financiare²⁸ po ashtu informon se nuk ka miratuar procedurë të brendshme për trajtimin e kërkesave për qasje të lirë në informata.

Sekretariati i Përgjithshëm nuk ka miratuar procedura të brendshme për trajtimin e kërkesave për qasje në informatat me karakter publik, por njofton se *“në pajtim me Ligjin për qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 101/2019), Udhëzimin për Zbatimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/2020) dhe në koordinim me AQLI-në, siguron transparencë proaktive të informacionit duke ruajtur, përditësuar dhe publikuar informacionin në faqen e internetit.”*. Në ueb-faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë është krijuar një seksion i veçantë për transparencë, ku publikohen shumë të dhëna dhe informacione me karakter publik.

Agjencia për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik i ka publikuar procedurat e brendshme në ueb-faqen e saj. MMJPH-ja ka miratuar procedurë të brendshme për mënyrën e sigurimit të informatave me karakter publik. Ajo është pjesë e procedurave ISO për të cilat MMJPH-ja është në proces të certifikimit. Gjithashtu, në ueb-faqe është publikuar [Udhëzimi për zbatimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik](#) të Agjencisë për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik. Ministria e Bujqësisë njofton se nga viti 2024, kërkesat për qasje të lirë në informatat me karakter publik mbahen në Regjistrin 1 (UP1). Lidhur me “procedurën për publikimin aktiv të të dhënave”, Ministria ka përgatitur listën e dokumenteve që ngarkohen në ueb-faqen www.mzsv.gov.mk. Ky dokument, përveç emrit të informacionit, përmban edhe intervalin kohor kur informacioni përditësohet.

Ministria e Drejtësisë njofton se aktualisht është duke funksionuar në grup pune, i cili diskuton për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Qasje të Lirë, i cili do t'i përmbajë edhe ndryshimet ligjore për

²⁸ Numri i arkivit 08-83/47

zgjerimin e kompetencave të Agjencisë dhe fshirjen e afatit për parashtrimin e ankesës në rastet e heshtjes administrative.

Monitorimi i kryer nga Fondacioni Metamorfozis tregon se asnjë masë e vetme nuk është zbatuar plotësisht në periudhën e planifikuar, e as nuk është përmbushur në mënyrë të njëjtë nga të gjithë aktorët.

Transparenca fiskale e qeverisë dhe e organeve të tjera në pushtetin ekzekutiv

Në kapitullin “Transparenca Fiskale e Qeverisë dhe e Organeve të Tjera në Pushtetin Ekzekutiv” kanë dy masa që përmbajnë aktivitete të planifikuara për t'u zbatuar plotësisht brenda tremujorit të parë të vitit 2025. Masa e parë është “Lidhja e të dhënave për furnizimet publike të vendosura në ueb-faqet e ministrive dhe organeve dhe organizatave të tjera që mbulohen nga kjo Strategji dhe i atyre në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike, në mënyrë që të dhënat të korrespondojnë; ndërsa masa e dytë është “Përmirësimi i Mjetit për llogaridhënien e shpenzimeve të bartësve të funksioneve publike”

Për këto dy masa janë paraparë dy aktivitete, për përmbushjen e të cilave kemi kërkuar përgjigje nga Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe nga të gjitha institucionet tjera, të cilave iu është dërguar Kërkesa për qasje të lirë në informatat me karakter publik.

Aktivitetet që duhej të zbatoheshin në vitin e parë janë:

- Publikimi i procedurave të brendshme për furnizime publike në ueb-faqet e institucioneve;
- Çdo institucion duhet të përditësojë individualisht mjetin për llogaridhënien e shpenzimeve të bartësve të funksioneve publike në mënyrë të vazhdueshme.

Monitorimi i kryer nga Fondacioni Metamorfozis tregon se ***detyrimet e parapara në këtë kapitull janë përmbushur pjesërisht, gjegjësisht publikimi i procedurave për furnizime publike është kryer në shumicën e institucioneve, por megjithatë nuk janë publikuar në të gjitha institucionet; dhe se përditësimi i mjetit për llogaridhënie bëhet nga një numër i madh institucionesh, por përsëri, jo nga të gjitha.***

MMJPH-ja bën me dije se procedura e brendshme për furnizime publike është publikuar në ueb-faqen e tyre. Ministria e Mbrojtjes i ka publikuar procedurat e brendshme për furnizime publike, të gjitha rregulloret në rubrikën Legjislacioni – Aktet nënligjore. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, gjithashtu, i ka publikuar procedurat e brendshme për furnizime publike në ueb-faqe dhe njofton se është krijuar një baner që çon në të dhënat e publikuara të llogaridhënies, por ato nuk janë përditësuar që nga viti 2018. Byroja e Furnizimeve Publike, sikurse edhe DÇMHJ-ja, i ka publikuar procedurat e brendshme për furnizime publike.

Ministria e Drejtësisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Policisë Financiare dhe Drejtoria e Inteligjencës Financiare kanë publikuar në ueb-faqet e tyre procedurat për furnizime publike. Në ueb-faqen e QRMV-së janë publikuar procedurat e brendshme për furnizime publike. Procedura për fillimin dhe zbatimin e procedurave për furnizimet publike dhe përgatitjen, lidhjen dhe realizimin e kontratave, gjendet në ueb-faqen e tyre, menjëherë pas kontratave të realizuara, njofton Ministria e Shëndetësisë.

Agjencia e Rezervës së Mallrave²⁹ i ka miratuar procedurat e brendshme për furnizime publike, mirëpo ato nuk i ka publikuar në ueb-faqe. Inspektorati Shtetëror i Inspektimit Teknik, që u riemërua në Inspektorati Shtetëror i Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale³⁰, nuk i ka publikuar procedurat e brendshme për furnizime publike, thuhet në shkresën e tyre.

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale nuk ka procedura të brendshme për furnizime publike. Ata njoftojnë se kryejnë vetëm furnizime publike në shkallë të vogël, për nevoja të brendshme të ministrisë.

Sa i përket mjetit për transparencë, Ministria e Mjedisit Jetësor, me kërkesë të Qeverisë, çdo tre muaj dorëzon raporte për shpenzimet e bartësve të funksioneve në institucion. Drejtoria e Policisë Financiare në ueb-faqen e saj ka në dispozicion një mjet për llogaritjen e shpenzimeve të ushtruesve të funksioneve publike. DÇHM-ja e përditëson rregullisht mjetin e llogaridhënies dhe ai është publikuar edhe në ueb-faqen e tyre. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave bën me dije se mjeti i llogaridhënies nuk është përmirësuar.

Sekretariati i Legjislacionit³¹ informon se nuk ka nevojë të përditësohet mjeti sepse nuk ka shumë shpenzime të tilla dhe se në faqen e tyre publikohet tabela e transparencës.

Në shkresën që na e dërgoi Ministria e Financave³², thuhet: "*për sa i përket pyetjes nëse janë miratuar procedura të brendshme për trajtimin e kërkesave për qasje në informacion dhe procedurë për publikimin aktiv të të dhënave duke përdorur AQLI-në dhe me numrin rendor 4 nëse janë publikuar procedurat e brendshme për furnizime publike në ueb-faqen e institucionit, ju informojmë se të dhënat e kërkuara nga kërkuesi nuk janë publikuar në Listën e Informatave me Karakter Publik me të cilat disponon Ministria e Financave, dhe me këtë rast, procedurat e brendshme, dhe ato akte që janë pronësi intelektuale, janë publikuar në rrjetin e brendshëm të Ministrisë për nevojat e punonjësve*".

Të dhënat e hapura dhe përdorimi i të dhënave të hapura të sektorit publik

Rritja e ndërgjegjësimit institucional për nevojën dhe për përfitimet nga të dhënat e hapura është qëllimi i përgjithshëm i kapitullit "*Të dhënat e hapura dhe përdorimi i të dhënave të sektorit publik*". Këtu janë dy masa me po aq aktivitete të planifikuara për t'u zbatuar në periudhën e monitoruar. Masa "*Forcimi i kulturës institucionale për të dhëna të hapura*", është nën të njëjtin qëllim të veçantë 1.

Masa "*Identifikimi i kategorive të të dhënave me rëndësi për organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin e biznesit*" është nën qëllimin e veçantë 2 "*Avancimi i mundësive digjitale të institucioneve për të lehtësuar dhe automatizuar procesin e hapjes së të dhënave*".

Sipas planit të veprimit, në periudhën nga miratimi i Strategjisë deri në tremujorin e parë të vitit 2025 janë paraparë:

1. Promovimi i portalit dhe i të dhënave të hapura të disponueshme përmes rrjeteve sociale, ngjarjeve, takimeve promovuese etj., përmes pesë ngjarjeve promovuese me postime në mediat sociale;

²⁹ Numri i arkivit 08-83/51

³⁰ Numri i arkivit 08-17/10

³¹ Numri i arkivit 08-83/41

³² Numri i arkivit 08-17/6

2. Publikimi i të dhënave të kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile dhe kompanitë private të mbuluara nga analiza Ex-post për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e të Dhënave të Sektorit Publik;

Monitorimi i kryer tregoi se ***këto dy aktivitete nuk janë realizuar***. Disa institucione i publikojnë të dhënat e kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile dhe kompanitë private, ndërsa disa i publikojnë në format të hapur, por me iniciativën e tyre.

Byroja për Furnizime Publike³³ dhe Inspektorati Shtetëror i Transportit³⁴ janë të vetmet institucione që raportuan se kishin kryer disa promovime gjatë periudhës së monitoruar: Byroja për Furnizime Publike ka publikuar një video promovuese për portalin e të dhënave të hapura, ndërsa Inspektorati Shtetëror i Transportit ka ndarë informacionin se promovimi është kryer në profilin e tyre zyrtar në Facebook.

Inspektorati Shtetëror i Transportit bën me dije se në realizim e sipër është procedura e tenderimit për përzgjedhjen e një kompanie të Ti-së për mirëmbajtje, e cila më pas do të kujdeset për ngarkimin e dokumenteve në ueb-faqen e tyre.

Po e citojmë përgjigjen origjinale të Sekretariatit të Përgjithshëm: *“Nuk është bërë promovimi i portalit për të dhënat e hapura dhe i të dhënave të hapura të disponueshme përmes rrjeteve sociale, ngjarjeve, takimeve promovuese, etj. Kjo masë ishte planifikuar të zbatohet nga ish-MSHIA-ja, por me ndarjen në përputhje me ligjin, institucioni kompetent për zbatimin e kësaj mase do të jetë Ministria e Administratës Publike”*.

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor informoi se “rregullisht i përditëson të dhënat nën kompetencën e saj në portalin data.gov.mk, i cili aktualisht, për arsye të panjohura për ne, nuk funksionon për një periudhë të gjatë kohore”. Ministria e Mbrojtjes bën me dije se i publikon buxhetet në format të lexueshëm nga makina në ueb-faqen e saj, ndërsa Ministria e Mjedisit Jetësor na dërgoi linkun e mëposhtëm si përgjigje: <https://www.moep.gov.mk/ministerstvo/transparentnost/informacii-javen-karakter>

Ministria e Bujqësisë bën të ditur se të dhënat e kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile dhe sektori i biznesit përmes kërkesave për qasje të lirë në informata publikohen më pas. Sa i përket masës së dytë, Sekretariati i Përgjithshëm na bëri me dije se institucioni kompetent që mund të përgjigjet për publikimin e të dhënave të kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile dhe kompanitë private të mbuluara me analizën ex-post për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e të Dhënave të Sektorit Publik, është Ministria e Administratës Publike.

Në përgjigjen e saj, MM-ja thekson se në përputhje me Rregulloren për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Transparencë në Ministrinë e Mbrojtjes të datës 14.1.2021, MM-ja i publikon të gjitha përgjigjet në pyetjet e parashtruara në përputhje me Ligjin për QLIK-pë. Kjo i përfshin edhe kërkesat e pranuar nga organizatat e shoqërisë civile dhe personat e tjerë fizikë dhe juridikë.

Të gjitha të dhënat e publikuara nga Enti i Statistikave³⁵ në komunikatat dhe publikimet janë të lira për t'u përdorur. Baza e të dhënave MakStat që mirëmbahet nga ky institucion i plotëson të gjitha kriteret për të dhënat e hapura, duke përfshirë edhe mundësinë e shkarkimit të të dhënave përmes API. Në ueb-faqen e

³³ Numri i arkivit 08-17/1

³⁴ Numri i arkivit 08-83-42

³⁵ Numri i arkivit 08-83/43

Entit të Statistikave ka një link që çon në Infrastrukturën Kombëtare të të Dhënave Hapësinore – Gjeoportali Kombëtar i IKDHH.

Transparenca gjatë miratimit të akteve dhe vendimeve

Kapitulli përmban dy masa me gjithsej gjashtë aktivitete, por asnjëra nuk është planifikuar të përfundojë deri në tremujorin e parë të vitit 2025. Qëllimi i përgjithshëm është forcimi i transparencës në krijimin e politikave qeveritare, si propozim-ligjeve, akteve nënligjore, strategjive, përmes konsultimit të detyrueshëm të publikut.. Të gjashtë aktivitetet janë planifikuar të fillojnë më 1 janar të këtij viti.

Transparenca e proceseve

Qëllimi i përgjithshëm i kapitullit “Transparenca e proceseve” është “Sigurimi i integritetit dhe transparencës gjatë marrjes së vendimeve për të cilat personi udhëheqës përdor autorizimin ose pushtetin diskrecional”. Në këtë kapitull janë dy masa që duhen zbatuar në periudhën e monitorimit. Masa *Transparenca e kompetencave diskreionale* është pjesë e qëllimit të veçantë 1 *Përdorimi i masave për transparencë si mjet për ngushtimin e hapësirës për keqpërdorim të kompetencave diskreionale*.

Avancimi i Kodit në drejtim të avancimit të parimeve të qeverisjes së mirë dhe rregullave të sjelljes së funksionarëve të emëruar është masa e qëllimit të veçantë 2 *Inkurajimi i përgjigjes për përdorimin e kompetencave diskreionale nëpërmjet llogaridhënies dhe shpjegimeve të detyrueshme*.

Janë planifikuar dy aktivitete:

1. Publikimi i informacionit me rëndësi për publikun në lidhje me veprimet e zbatuara dhe masat inspektuese të ndërmarra me qëllim të mbrojtjes së interesave financiare publike, Raporti vjetor për punën e inspektimit financiar dhe aktvendimi për refuzimin e një raportimi anonim për inspektim financiar;
2. Publikimi i raporteve nga zbatimi i Kodit.

Për aktivitetin e parë, institucion përgjegjës është Ministria e Financave/Spektori për Inspektimin Financiar në Sektorin Publik dhe Koordinimin e Luftës kundër Mashtrimit me Fondet e BE-së, ndërsa institucioni përgjegjës për aktivitetin e dytë është Kabineti i Zëvendëskryeministrit Përgjegjës për Qeverisjen e Mirë. Në përgjigjen e Ministrisë së Financave thuhet se rregullisht publikohen raportet vjetore për punën e inspektimit financiar dhe aktvendimet për refuzimin e raportimeve anonime për inspektim financiar nga Ministria e Financave.

Kjo masë është zbatuar plotësisht.

Lidhur me masën e dytë, gjegjësisht “Publikimi i raporteve nga zbatimi i Kodit”, në shkresën e koordinuar të Kabinetit të Zëvendëskryeministrit dhe Sekretariatit të Përgjithshëm thuhet se Kodi i Sjelljes Etike të anëtarëve të Qeverisë dhe bartësve të funksioneve publike të emëruar nga Qeveria, në bazë të Vendimit të Qeverisë, është në kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë. Sipas shkresës së tyre, ata janë në pritje të iniciativës së Ministrisë përkatëse.


Korniza për monitorim, vlerësim dhe raportim

Në Kornizën për monitorim, vlerësim dhe raportim thuhet: *“Për të siguruar zbatimin sa më të suksesshëm të Strategjisë për Transparencë të QRMV-së, është paraparë formimi i një njësie pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së, e cila do të ngarkohet me mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në lidhje me zbatimin e këtij dokumenti strategjik. Kjo njësi do të përgatisë raporte për zbatimin e Strategjisë për Transparencë të QRMV-së (dhjetor 2023 – dhjetor 2026), gjegjësisht Planin e veprimit, të cilat Sekretariati i Përgjithshëm do t'ia dorëzojë Zëvendëskryeministrit Përgjegjës për Politikën e Qeverisjes së Mirë. Më pas, Zëvendëskryeministri Përgjegjës për Politikën e Qeverisjes së Mirë, do t'ia dorëzojë ato raporte QRMV-së për zbatimin e Strategjisë.”*

Në momentin e shkrimit të raportit, njësi e posaçme në Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së, e cila do të merret me monitorimin, vlerësimin dhe raportimin në lidhje me Strategjinë për Transparencë, ***nuk është formuar, por kanë filluar aktivitetet bazë për strukturimin e saj.***

Formimi i njësisë organizative për zhvillim strategjik dhe transparencë pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së lidhet me Masën 3 të fushës së parë prioritare.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE



Vërejtje përfundimtare

Konkluzioni përfundimtar nga monitorimi është se zbatimi i Strategjisë për Transparencë ka ngecur në pjesën më të madhe të periudhës së zbatimit të saj. Nga numri i përgjithshëm i aktiviteteve në Planin e Veprimit, vetëm një është zbatuar plotësisht.

Nuk ka asnjë informacion në publik për statusin e zbatimit të Strategjisë, e që janë informuar as palët e interesuara për angazhimin e qeverisë për zbatimin e zotimeve apo për planin për ristrukturimin dhe përshtatjen e kornizës kohore. Me qëllim të arritjes së vizionit të kësaj Strategjie, gjegjësisht të krijimit të besimit të qytetarëve në Qeverinë e RMV-së, komunikimi dhe raportimi për të gjitha politikat e miratuara nga qeveria tek publiku duhet të jetë konsekuent dhe në kohë.

Prandaj, aktiviteti që aktualisht është kyç dhe duhet të zbatohet urgjentisht është krijimi i një njësie të posaçme në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së, e cila do të merret me monitorimin, vlerësimin dhe raportimin në lidhje me Strategjinë për Transparencë.

PASQYRË TABELORE E ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT



Pasqyrë tabelore e zbatimit të Planit të Veprimit

<i>Fusha prioritare 1</i>	<i>Masat</i>	<i>Aktivitetet</i>	<i>Data (tremujori) e planifikuar e zbatimit</i>	<i>Treguesit e performancës</i>	<i>Institucioni përgjegjës</i>	<i>Statusi i realizimit</i>
Fusha prioritare 1: Transparenca aktive e qeverisë dhe organeve të tjera të pushtetit ekzekutiv	M1: Inkurajimi i transparencës aktive përmes qasjes në informacion	A1.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet AMDQLIKP-së dhe Qeverisë në ngritjen e nivelit të transparencës së poseduesve të informacionit	I/2025	A1.3 Janë mbajtur 3 mbledhje tematike tremujore të QRMV-së për të vënë në dukje mospërputhjet në transparencë tek poseduesit e informacionit;	SP i QRMV-së/AMDQLIKP	
		A1.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet AMDQLIKP-së dhe Qeverisë në ngritjen e nivelit të transparencës së poseduesve të informacionit	I/2025	A1.4 Broshura, përgatitja e një fushate mediatike dhe materialeve të tjera promovuese nga QRMV-ja, në bashkëpunim me AMDQLIKP-në, shoqatat qytetare, fondacionet dhe mediat; A1.5 Janë publikuar	SP i QRMV-së/AMDQLIKP	

				informacione që kanë rezultuar nga përgjigjet e dhëna në kërkesat për qasje në informacion;		
	M.2. Standardizimi i qasjes ndaj transparencës aktive	A.2.4 Krijimi i ueb-seksioneve në ueb-faqen e Qeverisë për Ministrat pa portofol	I/2025	A.2.4 Ueb-seksionet e krijuara	SP i QRMV-së	
	M.2. Standardizimi i qasjes ndaj transparencës aktive	A2.5 Shënimi i komunikatave, videove, fotografive të krijuara nga shërbimet e marrëdhënieve me publikun me filigranë	vazhdimisht	A2.5 Bëhet dallim ndërmjet produkteve gazetareske dhe komunikimit të qeverisë	QRMV-ja/ministritë/të gjitha institucionet	
	M3. Formimi i një njësie organizative për zhvillim strategjik dhe transparencë, në kuadër të SP të QRMV-së	A3.1 Trajnim për punonjësit në njësinë organizative	II/2024	A3.1 Ndryshime në aktin e sistematizimit, punonjës të trajnuar	SP i QRMV-së	
Fusha prioritare 1: Transparenca aktive e qeverisë dhe organeve të tjera të	M.1. Luftimi i praktikës së dëmshme të injorimit (heshtjes së administratës) të kërkesave për qasje në	A1.2. Ndryshime ligjore për zgjerimin e kompetencave të Agjencisë dhe fshirjen e afatit për paraqitjen e ankesës në rast të heshtjes së administratës	I / 2025	A1.2 Ndryshime të miratuara ligjore për zgjerimin e kompetencave të Agjencisë dhe fshirjen e afatit për paraqitjen e	Ministria e Drejtësisë/AMDQLIKP-ja	


pushtetit ekzekutiv	informatat me karakter publik			ankesës në rast të heshtjes së administratës.		
	M2. Zbatimi i parimit të delegimit të kompetencave në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik	A2.1 Akt i brendshëm në nivel të institucionit	I / 2025	A2.1 Akt i miratuar i brendshëm në nivel të institucionit	SP i QRMV-së / të gjitha institucionet	
	M3. Trajtimi i kërkesave për qasje të lirë në informatat me karakter publik	A3.1 Përgatitja e procedurave të brendshme për shqyrtimin e kërkesës për qasje në informata dhe e procedurës për publikimin aktiv të të dhënave me ndihmën e AQLI-së	I / 2025	A3.1 procedura të miratuara të brendshme për veprimin e kërkesës për qasje në informacion dhe procedurë për publikimin aktiv të të dhënave me ndihmën e AQLI-së	SP i QRMV-së / të gjitha institucionet	

Transparenca fiskale e qeverisë dhe e organeve tjera pushtetit ekzekutiv	M1. Lidhja e të dhënave për furnizimet publike të vendosura në ueb-faqet e ministrive dhe organeve dhe organizatave të tjera që mbuloohen nga kjo Strategji dhe i atyre në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike, në mënyrë që të dhënat të korrespondojnë.	A1.2 Publikimi i procedurave të brendshme për furnizime publike në ueb-faqet e institucioneve	III/2024	A1.2 procedura të publikuara në ueb-faqet e institucioneve	SP i QRMV-së/të gjitha institucionet	
	M3. Përmirësimi i Mjetit për llogaridhënien e shpenzimeve të bartësve të funksioneve publike	A3.1 Çdo institucion individualisht ta përditësojë mjetin në vazhdimësi	I/2025	A3.1 Të dhëna të përditësuara për mjetin e llogaridhënies	SP i QRMV-së/të gjitha institucionet	
Të dhënat e hapura dhe përdorimi i të dhënave të hapura të sektorit publik	Qëllimi specifik 1, M1. Forcimi i kulturës institucionale për të dhëna të hapura	A1.1 Promovimi i portalit dhe i të dhënave të hapura të disponueshme përmes rrjeteve sociale,	I/2025	A1.1 Pesë ngjarje promovuese me postime në mediat sociale	SP i QRMV-së/MSHIA-ja/Poseduesit e të dhënave me karakter publik	

		ngjarjeve, takimeve promovuese, etj.				
	Qëllimi specifik 2, M2. Identifikimi i kategorive të të dhënave me rëndësi për organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin e biznesit	A2.1 Publikimi i të dhënave të kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile dhe kompanitë private të mbuluara nga analiza Ex-post për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e të Dhënave të Sektorit Publik	III/2024	A2.1 Kategori të reja të të dhënave të publikuara	MSHIA-ja/të gjitha institucionet	
Transparenca e proceseve	Qëllimi specifik 2, M1. Transparenca e kompetencave diskrecionale	A1.6 Publikimi i informacionit me rëndësi për publikun në lidhje me veprimet e zbatuara dhe masat inspektuese të ndërmarra me qëllim të mbrojtjes së interesave financiare publike, Raporti vjetor për punën e inspektimit financiar dhe aktvendimi për refuzimin e një raportimi anonim për inspektim financiar	Në vazhdimësi	A1.6 Janë publikuar informacione me rëndësi për publikun në lidhje me veprimet e zbatuara dhe masat inspektuese të ndërmarra me qëllim të mbrojtjes së interesave financiare publike, Raporte vjetore për punën e inspektimit financiar dhe	Ministria e Financave/Sektori për Inspektimin Financiar në Sektorin Publik dhe Koordinimin e Luftës kundër Mashtrimit të Fondeve të BE-së	

				aktvendimi për refuzimin e raportimeve anonime për inspektim financiar		
	Qëllimi specifik 2, M2. Avancimi i Kodit në drejtim të avancimit të parimeve të mirëqeverisjes dhe rregullave të sjelljes së funksionarëve të emëruar	A2.2 Publikimi i raporteve nga zbatimi i Kodit	Në vazhdimësi	A2.2 Raportet e publikuara në ueb-faqen e QRMV-së	KZKQRMV	

SHTOJCA 1: METODOLOGJIA



Shtojca 1: Metodologjia

METODOLOGJIA E MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË PËR TRANSPARENCË TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Kjo metodologji është zhvilluar për të monitoruar dhe vlerësuar (1) zbatimin e plotë dhe (2) në kohë të Planit të Veprimit të Strategjisë për Transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Monitorimi mbulon 40 institucione të nivelit qendror të përzgjedhura rastësisht dhe kryhet çdo vit. Mjetet që aplikohen gjatë monitorimit përfshijnë (1) një pyetësor të dorëzuar sipas kërkesave për qasje të lirë në informatat me karakter publik deri te institucioni përgjegjës për zbatimin e masave të caktuar si dhe (2) monitorim online të ueb-faqeve të institucioneve përgjegjëse. Monitorimi bazohet në treguesit dhe afatet e Kornizës për Monitorim dhe Vlerësim, të përfshirë në Planin e Veprimit, me shtesa të vogla. Në rastet kur të gjitha institucionet që mbulohe nga Strategjia janë përgjegjëse për zbatimin e një mase të caktuar, informacioni do të kërkohe nga të 40 institucionet e përfshira në këtë hulumtim.

Vlerësimi i zbatimit të masave do të kryhet në katër nivele, të paraqitura në figurën e mësipërme.

Është vonuar/Nuk është zbatuar	Në realizim e sipër	E përfunduar plotësisht me vonesë	E përfunduar plotësisht në kohë

Aktiviteti vlerësohet si **i vonuar** nëse nuk ka filluar përpara afatit për zbatim të parashikuar në Planin e Veprimit. Aktivitetet që nuk do të fillojnë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Planit të Veprimit, në fund do të vlerësohen si **të pazbatuara**.

Aktiviteti vlerësohet se është **në realizim e sipër** nëse ka filluar brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit dhe ende nuk ka përfunduar.

Aktiviteti vlerësohet si **i përfunduar plotësisht me vonesë** nëse është përfunduar plotësisht, por pas skadimit të afatit të parashikuar në Planin e Veprimit.

Aktiviteti vlerësohet si **i përfunduar plotësisht në kohë** nëse është përfunduar plotësisht brenda afatit kohor të paraparë në Planin e Veprimit.

Në rastet kur disa institucione janë përgjegjëse për zbatimin e një aktiviteti të caktuar, ai do të vlerësohet si i përfunduar **vetëm nëse dhe kur të 40 institucionet e monitoruara ta zbatojnë plotësisht atë**.

SHTOJCA 2: LISTA E INSTITUCIONEVE TË MONITORUARA



Shtojca 2: Lista e institucioneve të monitoruara

Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (GENSEK)

Kabineti i Zëvendëskryeministrit Përgjegjës për Qeverisje të Mirë në Qeverinë e RMV-së

Ministria e Punëve të Brendshme (MBP)

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme

Ministria e Financave

Ministria e Ekonomisë dhe Punës

Ministria e Transportit

Ministria e Kulturës dhe Turizmit

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (MMJPH)

Ministria e Mbrojtjes (MM)

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale (MVL)

Ministria e Shëndetësisë

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave (MBPEU)

Ministria e Administratës Publike (MAP)

Ministria e Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive (MMB)

Ministria për Çështje Evropiane (MÇE)

Ministria e Energjisë, Minierave dhe Burimeve Minerale

Ministria e Transformimit Digjital (MTD)

Ministria e Sportit

Drejtoria e Policisë Financiare

Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor

Byroja për Furnizime Publike (BFP)

Inspektorati Shtetëror i Tregut (ISHT)

Drejtoria për Çështje Hidrometeorologjike (DÇHM)

Byroja e Metrologjisë

Agjencia e Rezervës së Mallrave

Drejtoria Doganore

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)

Sekretariati i Legjislacionit

Drejtoria e Inteligjencës Financiare

Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve

Inspektorati Shtetëror Administrativ (ISHA)


Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale

Inspektorati Shtetëror për Inspektimin Teknik (ISHIP)

Inspektorati Shtetëror i Transportit (ISHT)

Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik (AMDQLIKP)

Enti Shtetëror i Statistikave (ESHS)



METAMORPHOSIS

Fondacion për internet dhe shoqëri